



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

BASHKIA KURBIN

Nr. _____ prot.
më. _____. _____. 2020

Laç,

SPECIFIKIME TEKNIKE

Për të realizuar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e gjelbërimit në Njësinë Administrative Laç, Njësinë Administrative Milot dhe Njësinë Administrative Fushe-Kuqe janë përcaktuar specifikime teknike si më poshtë vijon:

1. PASTRIMI NGA MBETJET URBANE I SIPËRFAQEVE TË GJELBERTA

Ky shërbim kryhet cdo ditë gjatë gjithë vitit kalendarik duke përfshirë edhe të dielat dhe ditët festive me punëtor zevendesues. Pastrimi nga mbetjet e sipërfaqeve të gjelberta do të kryhet në të gjithë inventarin në volume, sipërfaqe rruge e sheshe, sipërfaqe bari dhe sipërfaqe të luleve. Gjatë periudhës së verës mund të realizohen dhe volume pune të tjera për të përballuar ndotjet e stinës edhe në turnet e dyta. Pastrimi nga mbetjet e sipërfaqeve të gjelberta dhe grumbullimi i tyre do të bëhet me fshesa të tipit industrial dhe transporti i tyre do të bëhet nga subjekti nepermjet stacionit të transferimit. Ndalohen vendet e grumbullimit të mbetjeve për evadime të mevonshme në territoret urbane të vendit. Cdo mbeturinë e grumbulluar gjatë procesit të punës nuk do të jetë me shume se 10 m largësi nga vendet e pastrimit në cdo moment. Në sipërfaqet e gjelberta janë përfshirë edhe pastrimi e sistemit të vaskave të shatervaneve dhe ujrave të pakten një here në javë por edhe me shume në cdo rast eventual të mbindotjeve të tyre. Në këto raste do të kryhet edhe pastrimi me kreher që do të realizohet kryesisht në sipërfaqet e barit dhe të luleve por do të realizohet edhe buze bordurave të gjelberta dhe sipërfaqeve të tjera poshtë drureve halor dhe në ato sipërfaqe të vogla që nuk mund të pastrohen me fshesa. Ky element i shërbimit përfshin edhe transportin e mbetjeve të grumbulluara në vendin e caktuar ku me tej nepermjet stacionit të transferimit do të realizohet perpunimi dhe ndarja e mbetjeve të riciklueshme/riperdorshme nga ato për asgjësim, dhe me tej perpunimi i mbetjeve të ripërdorshme/riciklueshme.

Sipas nevojës dhe në ditët e planifikuara do të realizohet edhe nitrifikimi (për qëllime deratizimi, dezinfektimi ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve) i sipërfaqes së barit nëpërmjet proceseve të spërkatjes.

2. VADITJA

Do të realizohet pas mbjelljes së sipërfaqeve të barit, luleve, drureve dekorative, shkurreve dekorative dhe bordurat e gjelberta, gjithashtu vaditja do të realizohet në shërbime gjatë verës, por në raste të veçanta edhe në stinë të tjera. Sasia e ujit do të jetë jo më pak se 20 litra/m² në sipërfaqet e barit, luleve dhe jo më pak se 30 litra për 1 rrenjë në druret dhe shkurret dekorative.

3. KOSITJA E BARIT

Është një operacion sezonal, fillon në prill dhe perfundon në tetor jo më pak se 6 here. Sip. E barit do të kositen me makina- moto ose elektrokorrrese.

4. KRASITJA DHE TRAJTIMI I KURORAVE

Realizohet tek druret, shkurret dhe bordurat e gjelberta. Druret dhe shkurret krasiten duke filluar nga muaji dhjetor e në vazhdim. Druret gjetherenese përfundojnë krahasitjen në fillim të muajit mars, kurse ato gjethembajtes krasiten ne çdo kohë dhe 2 here në vit, forma e kurorave të tyre të jetë në formen gjeometrike të kërkuar.

Bordurat dhe shkurret e llojit ligustrum dhe oleander krasiten thuajse çdo muaj duke filluar nga muaji prill e deri në muajin tetor të çdo viti kalendarik.

Për druret do të aplikohen sipas preventivit të përcaktuar krasitje të rënda dhe krasitje të lehta, për dhënien e forms së kërkuar në varësi të rrugës dhe pamjes arkitektonike të pallateve.

Subjekti fitues dhe mbikqyresi i shërbimit do të bëjë njoftimet përkatëse për demtimet që realizohen në këtë fushë në kohen e duhur pranë Sektorit të Shërbimeve Publike në Bashki.

Të gjithë punonjësit pranë këtij aktiviteti të sipermarrësit janë përgjegjës material dhe kanë përgjegjësi financiare para administratorit në kuadrin e ruajtjes të të gjithë pasurisë së siperfaqeve te gjelberta. Personeli duhet të jetë i veshur me uniform gjatë gjithë kohës së punes.

Është bërë përlllogaritja e nr të nevojshëm të punëtorëve pas çdo analize të çmimit të zërit përkatës për gjithë volumin e punimeve të vitit kalendarik ose sezonal. Për llogaritjen e fuqisë punëtore është përdorur metoda e pjestimit të sasisë së punimeve vjetore sipas zërave analitike dhe normës për çdo njësi.

Sipas nevojës dhe ne ditet e planifikuara do të realizohet edhe plehrim me pleh kimik si dhe nëpërmjet proceseve të spërkatjes ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

5. PUNIMI I VENDEVE TE SHKELURA

Punimi i vendeve te shkelura ralizohet ne siperfaqet e barit te cilat jane shkelur nga kalimtare. Realizimi i ketij procesi pune behet per te rritur ne cdo kohe dekorin ne siperfaqet e lulishteve dhe per parandalimin e demtimeve nga kalimtare te ndryshem. Vendet e punuara ne siperfaqet e barit duhet te rrethohen me shirita kufizues dhe te vaditen me qellim mbirjen e barit te ri.

Ky process do te kryhet ne nje thelesi 15-20 cm. Volume i punimeve ne kete ze do te jete i pa kufizuar e rendesishme eshte qe ne siperfaqet e gjelberta te mos kete pjeseza te shkelura dhe te patrajtuara me qellim qe te ruhet dekori.

6. NDËRTIM SIPËRFAQESH TE GJEBERTA DHE MBJELLJE DRURËSH

Kur do të ketë nevojë për gjelbërim sipërfaqesh dhe mbjellje drurësh, ky proces do të realizohet nëpërmjet punimeve të sistemimit, drenazhimit, përgatitja e terrenit për mbjellje bari dhe

pemësh.

7. PAGESA E PUNIMEVE TË KRYERA, SITUACIONET.

Pagesa e punimeve (situacionet) kryhen nëpërmjet volumit të punimeve të reflektuara në process-verbalet e pjesshme, ditore, javore, mujore, të mbajtura ndërmjet përfaqësuesit të subjektit (sipërmarrësit) dhe mbikqyrësit (supervizorit) të Bashkisë duke llogaritur me çmimet e preventivave të fituar me tender për çdo zë punimi sezonal, të cilat janë të specifikuar në preventivat perkates. Pagesat ndryshojnë nga muaji në muaj sipas shërbimeve që do të kryhen në periudhat e percaktuara në preventive.

Të gjitha punimet e realizuara shprehen në situacione mujore (financiare) të firmosura nga subjekti sipërmarrës dhe mbikqyrësi (supervizori i Bashkisë).

Në raste kur krijohen dhe evidentohen dëmtimet në sipërfaqe të gjelbërta për arsye të moskryerjes së shërbimeve në kohën e duhur, mbikqyrësi i punimeve në bazë të process-verbaleve të mbajtura, llogarit vlerën e dëmit të krijuar dhe bën zbritjen e situacionit përkatës.

Subjekti nuk duhet të tejkalojë fondin vjetor të shërbimit për çdo zë punimi.

Për çdo ndryshim të volumit të punimeve apo të rritjes ose zvogëlimit të inventareve dhe për çdo ndryshim të pages minimale nga shteti, bëhen edhe ndryshimet në preventivë, rrjedhimisht në llogaritjen e fondeve vjetore dhe pagesat në situacione.

Standartet e bimeve dhe llojet që do të pranohen nga sipërmarrësi për mbjelljet në të gjitha strukturat do të bëhen sipas preventivit dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu sipas preventivit dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor do të përcaktohen standartet e dekorit dhe të paraqitjes pas punimeve dhe nevojave për ndërhyrje perpunime në të gjitha strukturat e aktivitetit të mirëmbajtjes në sipërfaqe të gjelbërta, sipërfaqe bari, lulesh, krasitje druresh dhe shkurresh dekorative etj.

1. PËR GJELBERIMIN E QYTETIT JANË PARASHIKUAR KËTO VOLUME VJETORE:

• Njësia Administrative Laç:

1. Mirëmbajtje lule 700m²
2. Mirëmbajtje bar i kultivuar 2198m²
3. Mirëmbajtje bar natyral 37600 m²
4. Mirëmbajtje dru dekorativ 2598m²
5. Mirëmbajtje shkurre dekorative 1040 rrënj
6. Mirëmbajtje ligustre 2600ml
7. Mirëmbajtje rrugë dhe sheshe 6215m²
8. F-v stola 45 copë

• Njësia Administrative Milot:

1. Mirëmbajtje dru dekorativ 60 cope
- **Njësia Administrative Fushe - Kuqe:**
 1. Mirëmbajtje dru dekorativ 55 cope

2. MJETET DHE PAISJET

- Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune perkatese për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Personeli duhet te jete i veshur me uniforme gjate gjithë kohes se punes.
- Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të të gjitha shërbimeve të gjelbërimit të përcaktuara më lart, këto mjete dhe paisje:

Mjet transporti vetshkarkues ≥ 1.5 ton (ngarkesa)	1 (një) copë
Mjet teknologjik me vinc dhe kazan vetëshkarkues per transportin e barit dhe pemeve dhe mbjelljen e pemëve	1 (një) copë
Makineri bujqesore me agregat/krah (jo më të vogël se 5m) për prerje shkurresh	1 (një) copë
Mjet per gjërmim me kove para dhe prapa për hapjen e gropave per mbjelljen e pemëve	1 (një) copë
Autobot uji per ujitje	1 (një) copë
Sharre universale per krasitje	2 (dy) copë
Gershere krasitese	3 (tre) cope
Makineri korrese bari	1 (një) copë
Aspirator per thithje gjethesh	1 (një) copë

3. Për zërat e punimeve të mësipërme është i nevojshëm **stacioni i transferimit** bazuar në VKM 319, dt.31.05.2019, Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pasi nevojitet per mbeturinat që dalin nga krasitjet dhe prerja e barit.
4. Operatori ekonomik fitues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punëtorve për realizimin e “Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta të Njesisë Administrative Laç, Njesisë Administrative Milot dhe Njesisë Administrative Fushë-Kuqe. Të ketë jo më pak se 16 punonjës në total, ku të përfshihen 1 (një) Ing. Mjedisi ose Ing.Agronom dhe 1 (një) Ing.Projektues/Arkitekt me licence perkatese.